

PKR.nr. 282/2016

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, si gjykatë e shkallës së parë penale, me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët Suzana Çerkini kryetare, Alltën Murseli dhe Arben Hoti anëtarë, në çështjen penale kundër të pandehurit I. H. nga fshati M., Komuna S., për shkak të veprës penale Furnizimi, Transporti, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 327 par. 1 të KPK, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut, tani Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.848-7/07 të datës 31.03.2008, pas shqyrtimit kryesor, të hapur për publikun, të mbajtur me datë 04.11.2016, me praninë e Prokurorit të shtetit Hivzi Bajraktari dhe të pandehurit I. H., në po të njëjtën datë, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri I.H., nga i ati O. dhe nëna M., e gjinisë A., i lindur më *data e lindjes...* në fshatin M., Komuna S., ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, i gjendjes së mesme, punon si punëtor ndërtimtarie, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse, me datën 20.10.2007 ia kishte premtuar dhe dhënë një revole të tipit Ekol Tuna të kalibrit 8 mm, të miturës M. A., ku gjatë bastisjes në shtëpinë e saj në fshatin M. Komuna P. i është gjetur revolja e tipit Ekol Tuna me numër serik T747387, të cilën e posedonte pa leje,

- me këtë ka kryer veprën penale Furnizimi, transporti, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve, nga neni 327 par.1 të KPK,

Andaj, gjykata, në bazë të neneve 11,15,34,41,42,43,44,45,54,60,64 të KPK dhe neneve 326, 365 dhe 366 të KPP, i shqipton,

D Ë N I M M E K U S H T

Në kohëzgjatje prej **1 (një)** viti i cili nuk do të ekzekutohet, nëse brenda afatit prej **2 (dy)** vjetësh nuk do të kryejë veprën e re penale, dhe

Obligohet i akuzuari të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor, obligohet të paguajë shumën prej nga **50 (pesëdhjetë) euro**, në afat prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë,

A r s y e t i m

Prokuroria Publike e Qarkut, tani Prokuroria Themelore, Departamenti i Krimeve të Rënda në Prishtinë, ka ngritur Aktakuzë PP.nr.848-7/07 të datës 31.03.2008, kundër të pandehurve A.A. për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK dhe, I. H. për veprën penale Furnizimi, transporti, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 327 par.1 të KPK si dhe, njëherësh ka propozuar gjykatës që të pandehurit t'i shpall fajtor dhe t'i dënojë sipas ligjit.

Gjykata, duke vepruar sipas aktakuzës së lartshënuar, të konfirmuar, ka nxjerrë Aktvendimin PKR.nr.2828/08, datë 25.03.2016, me të cilin ka vendosur për veçim të procedurës penale për shkak se i akuzuari I. H. ka qenë i paarritshëm për organet vendore të ndjekjes, gjegjësisht, sipas Memorandumit zyrtar të datës 21.03.2016 nga Stacioni Policor në Skenderaj, është konstatuar se i akuzuari I. H. ndodhet jashtë territorit të shtetit të Republikës së Kosovës, përkatësisht në Mal të Zi.

Në zbatim të urdhërit të datës 10.05.2016 të lëshuar nga gjykata, organet e ndjekjes kanë siguruar praninë e të akuzuarit I. H. në procedurë, andaj gjykata ka caktuar shqyrtimin gjyqësor me datë 04.11.2016, në të cilin shqyrtim, prokurori shtetit fillimisht ka bërë precizimin e aktakuzës, meqë dispozitivi i aktakuzës përmbanë edhe veprimet inkriminuese për të akuzuarin A.A., ndërsa procedura për të njëjtin tashmë ka pushuar me aktvendim të kësaj gjykate, andaj dispozitivi i aktkuzës është korrigjuar dhe lexuar saktësisht ashtu siç është i përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi. I akuzuari I.H., i vënë në dijeni të plotë për pasojat dhe përparësit e pranimin të fajësisë, vullnetarisht, në tërësi pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Pas pranimin të fajësisë nga i akuzuari, prokurori i shtetit theksoi se pajtohet me pranimin e fajësisë, pasi që ky pranim është në përputhje me dispozitat e KPP dhe, i mbështetur në prova të cilat gjenden në shkresat e lëndës, andaj i propozoi gjykatës që të aprovojë pranimin e fajësisë.

Pas mendimit të prokurorit të shtetit, gjykata, duke vlerësuar se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është dhënë në përputhje me dispozitat ligjore nga neni 326 të KPP, se i njëjti në mënyrë bindëse dhe vullnetarisht ka pranuar fajësinë, duke qenë në dijeni për natyrën, pasojat e pranimin të fajësisë dhe se pranimi është në përputhje të plotë me faktet e provat nga shkresat e lëndës, e aprovoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari I.H., për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, meqë në shqyrtim gjyqësor, i akuzuari I.H. ka pranuar fajësinë, vërtetohet se i njëjti ka kryer veprën penale Furnizimi, transporti, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve, nga neni 327 par. 1 të KPK, andaj mbetet në tërësi pranë aktakuzës dhe propozimit që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, njëherësh, i propozoi gjykatës që, gjatë matjes së dënimit gjykata ta merr parasysh pranimin e fajësisë, si rrethanë lehtësuese.

I akuzuari I.H., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se ndihet i penduar për veprën e kryer, prej atëherë deri më sot nuk ka kryer vepër tjetër penale lidhur me posedimin apo përdorimin e armëve, kërkoi nga gjykata të merr një vendim të drejtë sa më të butë ndaj tij.

Andaj gjykata, pasi që konstatoi se në veprimet e të akuzuarit formësohen të gjitha elementet e veprës penale Furnizimi, transporti, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve, nga neni 327 par.1 të KPK, pasi që më parë gjeti se i akuzuari është penalisht përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin e paraparë ligjor.

Gjatë matjes dhe përcaktimit të dënimit ndaj të akuzuarit të lartshënuar, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe masën e dënimit, pranimin e fajësisë e mori si rrethanë lehtësuese, ndërsa rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti, andaj të njëjtit i shqiptoi dënim me burgim të cilin ia kushtëzoi për periudhë të caktuar verifikuese, të precizuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i tillë i përgjigjet peshës së veprës penale, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarit, se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 34 të KPK dhe se i njëjti, në të ardhmen nuk do të përsëris vepër tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Vendimin për konfiskimin e sendit, të armës dhe gjësendeve të tjera, të mbajtura, përkatësisht të përdorura në mënyrë të paautorizuar, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 69 të KPRK lidhur me nenin 327 par.3 të KPK.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 453 par. 1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë, dhe në bazë të nenit 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/ DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.282/16, me datë 04.11.2016**

**Sekretarja juridike
Ardita Azemi**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Suzana Çerkini**

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, ankesa bëhet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.